



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. _____, datë _____

P Ë R

PROPOZIMIN KUVENDIT PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI
TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 114, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin Kuvendit për emërimin e z. Tomi Frashëri anëtar të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

RELACION

PËR

VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROPOZIMIN KUVENDIT PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE”

Vendimi parashikon propozimin Kuvendit për emërimin e z. Tomi Frashëri, anëtar të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Z. Tomi Frashëri ka kryer Bachelor në Drejtësi, Master 1 në të drejtë publike dhe Master i Shkencave në të drejtë publike të thelluar, në Universitetin Paris II – Pantheon – Assas.

Në vitet 2007 - 2010 ka qenë kërkues shkencor në Universitetin Paris II – Pantheon – Assas, Departamenti i së drejtës publike dhe historisë të së drejtës.

Në vitet 2010-2014 ka qenë në Zyrën e Ombudsman, në Paris, Francë (mbrojtja e të drejtave themelore, marrëdhënia me gjyqësorin).

Nga viti 2014 e në vazhdim është këshilltar për koordinimin protokollar dhe diplomatik, Drejtor i protokollit të Kryeministrit.

Z. Frashëri ka bërë një sërë punimesh universitare dhe publikime.

Përvoja dhe formimi i z. Frashëri përbëjnë garanci për kryerjen me sukses të detyrës së anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Bashkëlidhur këtij relacioni gjendet një CV e z. Tomi Frashëri.

Vendimi bazohet në nenin 114, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike dhe postare”, të ndryshuar.

KËSHILLI I MINISTRAVE